

ANILA OMARI**FJALËFORMIMI I SHQIPES SË VJETËR:
NJË KONTRIBUT I RI I JOACHIM MATZINGERIT**

Albanologjia e hapësirës gjermanishtfolëse, e themeluar dhe e përvijuar nga emra të mëdhenj si Johann Thunmann, Joseph Ritter von Xylander, Franz Bopp, Georg von Hahn, Gustav Meyer, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, e zhvilluar më tej nga albanologët e mirënjohur të gjysmës së dytë të shekullit XX Hermann Ölberg, Wilfried Fiedler e Oda Buchholz, po vijon traditën e saj të ndritur me albanologët e brezit të ri, ndër të cilët spikat emri i Joachim Matzingerit, tashmë i afirmuar si studiues me kontribute të rëndësishme në studimin e gjuhës shqipe, veçanërisht të fazave të vjetra të saj.

Me një formim të plotë në fushën e gjuhësisë së krahasuar indoeuropiane në universitete me emër, së pari në atë të Vjenës për studime magjistrale dhe më pas në Halle për studime doktorale, mbas disa punimesh të rëndësishme mbi shqipen e vjetër ku përballet me probleme nga më të vështirat e të pazgjidhura përfundimisht të teksteve të vjetra e të historisë së gjuhës shqipe, dhe mbas botimit të një studimi të gjerë e të plotë mbi foljet e shqipes së vjetër në bashkëpunim me një tjetër indoeuropianist me emër, Stefan Schuhmacherin, Matzingeri ka sjellë së fundi një kontribut tjetër në fushën e shqipes së vjetër (shek. XVI-XVII) bazuar në tekstin e librit të parë shqip ‘Mesharit’ të Gjon Buzukut dhe të teksteve të tjera të kësaj periudhe, dhe pikërisht në fushën e fjalëformimit, si një nga rrafshet më të rëndësishme të sistemit të gjuhës që tregon edhe për karakterin dhe shkallën e vitalitetit të një gjuhe. Titulli i veprës është “Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im altalbanischen bei Gjon Buzuku. Ein Beitrag zur Albanischen Lexikographie” (“Tipat e fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër të Gjon Buzukut. Një kontribut për leksikografinë shqipe”), botuar nga shtëpia botuese Harrassowitz, 2016, 593 f. Me fjalëformim sekondar autori kupton tipat e fjalëformimit që krijohen me anë mjetesh fjalëformuese të qarta nga pikëpamja sinkronike, si ndajshesa dhe kompozim, përkundrejt leksikut primar i cili në rrafshin sinkronik nuk është transparent dhe duket i pazbërthyesëm më tej.

Autori është përqendruar në fjalëformimin në sistemin emëror të shqipes së vjetër, pasi ky sistem nuk është hulumtuar sa duhet në këtë aspekt deri tani, ndërkohë që sistemi foljor i kësaj faze të shqipes është analizuar në gjerësi e imtësi në dy punime të rëndësishme: në studimin e Wilfried Fiedlerit *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)* (ASHAK,

Prishtinë, 2004) dhe në atë të Stefan Schumacher e Joachim Matzinger, *Die Verben des Altalbanischen. Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie* (Wiesbaden, Harrassowitz, 2013).

Punimi ka në radhë të parë meritën e përpunimit të plotë, në aspektin e fjalëformimit, të materialit të vjelë nga teksti i Buzukut, dhe jo vetëm të këtij autori të parë të shqipes, por të të gjithë autorëve të vjetër deri në mes të shekullit XVIII. Dokumentet shkrimore të marra në shqyrtim janë të gjitha tekstet e vjetra shqipe të njohura deri sot nga shek. 16 deri në shek. 18, që nga Buzuku (1555), Matrënga (1592), Budi (1618, 1621), Bardhi (1635), Bogdani (1685), Fjalori i Da Lecces (1702), Kuvendi i Arbënit (1703), Fjalori anonim italisht-shqip i vitit 1710, Gramatika e Da Lecces (1716), Dorëshkrimi i Kieutit (1736), Gjon Kazazi (1743), Jul Variboba (1762). Ai jep një pasqyrë mund të themi shteruese të tipave dhe mjeteve të fjalëformimit sekondar në sistemin emëror të shqipes së vjetër, duke dhënë edhe kontribute të reja në saktësimin e ndonjë mjeti fjalëformues, si dhe në fushën e prejardhjes dhe rrugës së formimit të disa mjeteve fjalëformuese.

Vepra përmban, në pjesën e dytë të saj, fjalorin e okurrencave të tipave të fjalëformimit në sistemin emëror në “Mesharin” e Gjon Buzukut, i cili përbën një ndihmesë të rëndësishme në leksikografinë shqipe.

Materiali është vjelë nga autori me kujdes dhe akribi shkencore, duke u mbështetur në kompetencat e tij si njohës i mirë i historisë së gjuhës shqipe dhe duke shfrytëzuar të gjithë autorët kryesorë që kanë trajtuar edhe fjalëformimin në studimet etimologjike të shqipes. Mund të themi me njëfarë sigurie se punimit nuk i kanë shpëtuar emra e mbiemra të formuar me mjete të fjalëformimit sekondar, të paktën në tekstin e Buzukut, por me shumë vëmendje është punuar edhe me tekstet e tjera të shqyrtuara. Mjafton të përmendim sa për shembull derivatin *kujdes* nga folja *kujtoj* që nuk e kanë Xhuvani-Çabej, por e ka Meyeri dhe Çabej (në SE V 158).

I gjithë materiali i grumbulluar është paraqitur sipas parimeve semantike të fjalëformimit duke u mbështetur në modelin e ofruar nga Wolfgang Motsch, në punimin e tij *Deutsche Wortbildung in Grundzügen* (Fjalëformimi i gjermanishtes në vijat themelore) 2004. Sipas këtij konceptimi, tipat e fjalëformimit janë pjesë e komponentes leksikore të gramatikës. Ato paraqiten si kombinim i veçorive semantiko-sintaksore dhe fonologjiko-morfologjike. Kreativiteti ose aftësia e modelit për të krijuar formime të reja mbështetet në anën semantiko-sintaksore, por ana fonologjike-morfologjike ka ndikimin e vet në modelin semantik dhe nuk mund të anashkalohet.¹ Tipat e fjalëformimit këtu shihen si rregulla që i përkasin leksikut të gjuhës, me gjithë informacionin semantik, sintaksor, fonologjik e morfologjik të nevojshëm për përdorimin e

¹ W. Motsch, *Deutsche Wortbildung in Grundzügen*, De Gruyter, Berlin, 2004, f. 1 v.

fjalëve të pathjeshta. Pra qasja e këtij punimi është ngushtësisht leksikaliste. Në qendër të vëmendjes janë modelet semantike, të cilat përshkruajnë mundësitë e ndryshimit semantik nga fjalët bazë te fjalët e prejardhura e kompozitat.

Sipas këtij modeli, tipat e fjalëformimit të shqipes së vjetër në veprën e Matzingerit janë paraqitur me skemën e mëposhtme, konkretisht, për shembull, në paraqitjen e prapashtesës *-átë*, që te Buzuku del në dy fjalë të prejardhura: *kapshatë*, *oratë*: [SM (modeli semantik); PF (forma fonologjike) v (baza foljore) *-átë* (f.); shm. *-a*].

Tipat e fjalëformimit që janë marrë në shqyrtim në punim organizohen në grupime të mëdha sipas mënyrave të fjalëformimit, me nënndarje të tjera hierarkike sipas temës fjalëformuese, përmbajtjes semantike të referentëve dhe mjeteve fjalëformuese. Si mënyra të fjalëformimit emëror autori dallon:

1. Prejardhjen me ndajshtesa, të ndarë në:

- Prejardhja prapashtesore: em. *ëndër* → mb. (i) *ëndër-shim*, që cilësohet si një mënyrë fjalëformimi mjaft e zakonshme në gjuhët indoevropiane. Me prejardhje prapashtesore formohen të gjitha llojet e mundshme të derivateve sekondare (emra abstraktë foljorë dhe emërorë, emra vepruesi, mbiemra, emra femërorë mocioni, deminutivë).

- Prejardhja parashtesore: mb. (i) *besuom* → mb. (i) *pā-besuom*. Kjo mënyrë është mjaft aktive sidomos në shqipen e re. Në Mesharin e Buzukut formimi parashtesor gjendet kryesisht në modelin e mohimit të fjalës (Wortnegation).

2. Kompozimi: *zemërëkeq* ← gjymt. e përp. emër *zemërë* + gjymt. e prapme mb. (i) *keq*. Edhe kjo mënyrë sipas autorit është e rëndomtë në shqipen.

3. Rikategorizimi sintaksor (= ndërrim i kategorisë në përdorimin sintaksor) (sipas traditës quhet emërzim ose substantivim): (mb.) (i) *mirë* → (em.) *të mirë*, (pjesore) *kushtuom* → (em.) *të kushtuom*. Në shqipen e vjetër është një mjet shumë prodhimtar për të krijuar emra abstraktë asnjans nga mbiemra marrëdhëniorë dhe nga mbiemra foljorë.

4. Konversioni: fjalëformim me ndërrim pjese të ligjëratës pa tipare dalluese. Konversioni është një model jo fort aktiv i shqipes së vjetër, më shumë dalin ndërtime me konversion të tipit emër (përk. mbiemër) → folje (p.sh. (i) *shëndosh* → *shëndosh-ën*) (në Gramatikën e Akademisë kjo mënyrë konsiderohet prejardhje pa ndajshtesa); konversione të tipit folje → emër (te Budi e Bogdani *mund* nga folja *mundon*, *sund* nga *sundoj*²).

Autori e dallon konversionin nga rikategorizimi sintaksor me faktin se konversioni prek rrafshin sintaksor dhe atë leksikor, duke u krijuar një fjalë e re me paradigmen e vet të posaçme, pra me këtë rast krijohet një konversion i

² Mendoj se emri *sund* është baza fjalëformuese e foljes *sundoj*, shih A. Omari, *Marrëdhëniet gjuhësore shqiptaro-serbe*, Botimet albanologjike, Tiranë, 2012, f. 279.

plotë (complete conversion). Nga ana teorike për këtë dallim mbështetet në veprat e Vogel 1996, Olsen 2014, Bauer & Valera 2005.³

Në punim ai është ndalur vetëm në shpjegimin e këtij modeli fjalëformimi, në kapitullin mbi parimet e fjalëformimit të shqipes së vjetër, dhe shënon se këtë model fjalëformimi në kufi midis sintaksës dhe fjalëformimit, meqenëse është një mjet i pakushtëzuar dhe shumë prodhimtar në shqipen e vjetër, i cili kërkon një hulumtim të veçantë, ai do ta ndërmarrë në një vend tjetër. Për shembuj rikategorizimi sintaksor në shqipen e vjetër i referohet Sh. Demirajt, Çështje të sistemit emëror, USHT, Tiranë, 1972 198-204. Ai e kufizon kështu materialin në shqyrtim në leksikon emëror e mbiemëror sekondar, pra të formuar me mjete eksplicite formale.

Meqenëse më tërhoqi vëmendjen qasja metodologjike e trajtimit të materialit, po ndalem pak në këtë aspekt, duke e krahasuar me Gramatikën e Akademisë së Shkencave.

Parimet e fjalëformimit të shqipes, të përpunuara sipas konceptit të Wolfgang Motsch, siç shihet janë të ndryshme nga ato që formulon Gramatika e Akademisë, në bazë të karakteristikave të gjuhës shqipe. Kjo gramatikë pranon 6 mënyra fjalëformimi të shqipes: 1. Prejardhjen me ndajshtesa, me nënndarjet e saj: a) prejardhje parashtesore, b) prejardhje prapashtesore, c) prejardhje parashteso - prapashtesore, ç) prejardhje pa ndajshtesë. 2. Nyjëzimin. 3. Kompozimin. 4. Përngjitjen. 5. Konversionin. 6. Mënyrat e përziera.

Nga shpjegimi që jep autori për rikategorizimin sintaksor, si proces i njohur edhe në gjuhë të tjera i.-e., ku një mbiemër ose pjesore ndërrojnë kategorinë leksikogramatikore, kjo mënyrë fjalëformimi është e njëjtë me atë që në Gramatikën e Akademisë quhet konversion. Sipas GA konversioni është mënyra e formimit të një fjale të re si pasojë e kalimit në një pjesë tjetër të ligjëratës për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit të saj. Duke kaluar në një pjesë tjetër të ligjëratës, fjala e formuar me këtë mënyrë ndërrohet edhe paradigmen e saj. Meqenëse në punim me rikategorizim sintaksor kuptohet ai që, sipas traditës, quhet emërzim, në GA me emërzim të mbiemrit kuptohet kalimi i tij në klasën e emrit pa ndryshim të jashtëm fjalëformues, pra pa ndajshtesa. Kjo mënyrë morfologjiko-sintaksore fjalëformimi quhet konversion. Këtu hyn emërzimi i mbiemrit si në shembullin *i mirë* → *të mirë*.

Rasti tjetër i rikategorizimit sintaksor është kalimi pjesore *kushtuom* → emër *të kushtuom*. Sipas GA kjo mënyrë fjalëformimi quhet *nyjëzim*.

Nyjëzimi në traditën gramatikore shqiptare konsiderohet si një mënyrë fjalëformuese shumë prodhimtare. Nyja formon mbiemra të nyjshëm nga pjesoret e foljeve dhe në këtë rast ajo luan rol të dyfishtë: fjalëformues dhe morfologjik. Formimin e mbiemrave prejpjesorë Matzingeri nuk e ka përfshirë

³ J. Matzinger, *Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im altpalbanischen bei Gjon Buzuku*, Harrassowitz, Wiesbaden, 2016, f. 82, shën. 50.

në studim, pasi ndërtimet me pjesore hyjnë në morfologjinë e foljes dhe për to ka lista të bollshme në treguesit e monografive të vëllimshme mbi Foljet e Gjon Buzukut dhe Foljet e shqipes së vjetër të përmendura më lart. Por sipas Gramatikës së Akademisë, nyjëzimi është një mënyrë prodhimtare edhe për formimin e emrave prejfoljorë asnjës e femërorë, si: *të ecur-it, të menduar-it, të folur-it, e qeshura* etj. që te Matzingeri përfshihet në konceptin e nominalizimit.

Matzingeri nuk i jep një rol fjalëformues nyjes në punimin e tij. Kjo shpjegohet me zbatimin e parimit semantik në paraqitjen e materialit për fjalëformimin emëror e mbiemëror, ku nyja nuk ka ndonjë rol kuptimor. Gjithsesi mendoj se në studimin e ardhshëm për mënyrën fjalëformuese të rikategorizimit sintaksor do të ishte e nevojshme të shtrohej për diskutim çështja e nyjes si mjet fjalëformues ose jo në shqipen e vjetër, meqenëse kjo çështje lidhet edhe me diskutimin e shkallës së vjetërsisë së nyjes së përparme në shqipe dhe përdorimin e saj të kufizuar në fazat e vjetra të shqipes dhe në të folme.⁴

Në të njëjtën qasje metodologjike, roli i nyjes nuk njihet as në tipin fjalëformues të formimeve privative, të cilat përfshihen si një kapitull më vete në fjalëformimin emëror. Formimet privative ndahen në dy grupe: mohimi i fjalës dhe marrëdhëniet privative. Për këtë model fjalëformues gjithashtu mbështetja teorike gjendet në veprën e W. Motsch, i cili përdor edhe termin Wortnegation (mohim i fjalës).

Te mohimi i fjalës, tipi fjalëformues formohet nga temë emërore me parashtesën *pa-*, së cilës në shqipen e vjetër i shtohet edhe nyja e përparme, pra (i) *pā-* : *pā-dekēnī, pā-ndēr*. Te Bogdani del një herë me nyje të përparme: *veshunë së pādekēnije*,⁵ dhe te Budi: *mos u banetë ndonjë e pāndēr*. Në shqipen e sotme mohimi i fjalës me *pa-* është pa nyje (*paafësi, padrejtësi* etj.)⁶.

⁴ Shih E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, "Buletin i USHT, Seria Shkencat Shoqërore", Tiranë, 1963, nr. 3, f. 69-101.

⁵ Te Bogdani do të shtonim edhe leksema të tjera të këtij tipi fjalëformues, si: **të paçmuem,-itë* I 121 10 ndëpër *të paçmuemit* e të pamarrë vesht të visare (per l' *inestimabili*, & incomprendibili tesori); **e padroe,-ja* fjalë e përdorur vetëm një herë dhe e krijuar me rastin e përkthimit të lat. *temeritas* "guxim i tepruar, kuturisje": I 6 26 Të bubërruemitë është një *të padroe* (Scrutari *temeritas* est); *të pādhimptunë* "mizori, zemërgurësi: it. *crudeltà*": II 105 28=19 ndo kujtonte se kurrë me aq të pādhimptunë kishinë me munduem (con tanta *crudeltà*); *të paginë,-të* "pangopësi, lakmi e madhe: it. *ingordigia*": II 68 18 për t u mbushunë *të paginëtë* farizejet e dobitë tyne (it. à beneficio della *ingordigia* de Farrisei); *të pakujdes* "pakujdesi: it. *trascuraggine*": I 102 20 meriton mortnë me gjithë sogje për këta *të pakujdes* kaqa të madh (per questa *trascuragine* tanto grande); *të paligjetë* "paligjshmëri; shkelje e besës: it. *infedeltà*"; **të pāmórt,-itë* "pavdekësi: it. *immortalità*"; *të panierëzishim,-itë* "çnjëri; jonjëri: it. *inumanità*": II 75 16 po fort shtrëjt kastigon të padashunitë e *të panierëzishimitë*

Në marrëdhëniet privative modeli fjalëformues është nga temë emërore dhe mbiemërore me (i) *pā-* : (i) *pā-besë*, (i) *pā-besim*, (i) *pābesuom*, (i) *pā-dhimshim*, etj. (këtu hyn edhe *i pākrështenë*).

Gramatika Akademike e shqipes bën dallim në këto tipe fjalëformimi. Formimet e tipit *i pādhimshim* janë formime privative ose antonimike me *pa-*, brenda së njëjtës klasë të mbiemrit të nyjshëm, ndërsa një formim si *i pabesë*, *i paarmë* është një mënyrë e përzier me nyjëzim + përngjitje, pasi nyjëzohet një tog parafjalor (*pa besë* → *i pabesë*, *pa armë* → *i paarmë*). Pra te Buzuku, sipas parimeve fjalëformuese të Gramatikës së shqipes, ndeshen edhe emra të formuar me mënyra të përziera (*i paarrësye*, *i paarmë*, *i pakërshenë*).

Gjithë materiali fjalëformues është strukturuar në formë zërash të veçantë për secilin mjet fjalëformues, të formuluar sipas skemës së dhënë nga W. Motsch për gjermanishten, ku çdo zë nyjëtohet në shtatë rubrika, nga të cilat tri të parat janë marrë nga modeli i Motschit dhe katër të tjerat janë krijuar rishtas nga autori për shqipen e vjetër. Së pari bëhet analiza semantike e tipit fjalëformues, ku renditen edhe të gjitha leksemat e tekstit të Gjon Buzukut të formuara sipas këtij modeli, leksema bazë e fjalëformimit dhe tema fjalëformuese. Së dyti bëhet analiza morfologjike, ku përshkruhet ana formale e krijimit të derivatit, ndryshimet fonologjike që ndodhin me këtë rast, dhe jepen të dhënat gramatikore të modelit. Rubrika e tretë është prodhimtaria ose siç e quan autori, aktiviteti i tipit fjalëformues në shqipen e vjetër, ku jepen dëshmitë në tekstet e vjetra pas Buzukut me shembujt përkatës të vjelë në mënyrë sa më të plotë, pas gjase shteruese, në mënyrë që të krijohet një gjykim i qartë për shkallën e prodhimtarisë së tipit. Trajtimi ndalet edhe në prodhimtarinë që ka një tip i caktuar në shqipen e sotme duke dhënë edhe një vështrim perspektiv të tipit fjalëformues. Për sa i përket terminologjisë, edhe këtu ka ndryshim me Gramatikën e Akademisë: sipas GA një tip fjalëformues quhet prodhimtar, kur në gjuhë ka një numër pak a shumë të madh fjalësh që i përkasin atij tipi. Një tip prodhimtar mund të jetë aktiv (veprues), kur sipas tij formohen rishtas fjalë të reja, ose joaktiv. Pra prodhimtar dhe veprues nuk janë e njëjta gjë. Në pikën 4 jepen shembujt ilustrues të ndërtimeve të trajtuara në analizën semantike me kontekstin e tyre në tekstin e Buzukut dhe në pikën 5. përgjegjëset latinisht të tyre në tekstet latine të marra për krahasim, aty ku është e mundur. Pika 6. përmban analizën diakronike të mjetit fjalëformues. Autori e ka konsideruar të

(punirà l'ingratitude, e l'inhumanità); **të panjëhun/ë,-itë** “numër i pafund: it. *infinità*”; ***të patëkéq,-të** “padjallëzi, pafajësi: it. *innocenza*”; **të pāzell-të** “mungesë zelli, përtaci”: XV ende tue kthym me fort të liga tregëti andej, për **të pāzell** tanë; **të pasosm,-itë** “pafundësi: it. *infinito*”: I 17 26 aso tri pikësh, qi janë ndë të pazanët e **të pasosmit**, II 16 15 të pashoq e **të pasosmitë** arit qi u përduer.

⁶ J. Matzinger, vep. cit., f. 262.

nevojshme përfshirjen e këndvështrimit diakronik, në një punim të karakterit kryesisht sinkronik, për shkak edhe të pasaktësive në shumë raste të studimeve të deritanishme, duke sjellë kontribute të reja në etimologjinë e një numri mjetesh fjalëformuese të shqipes. Rubrika e shtatë dhe e fundit është ajo e literaturës ekzistuese për secilin mjet fjalëformues të trajtuar.

Një meritë e autorit në zgjedhjen e teksteve fetare latine për krahasim me Buzukun është marrja në vështrim e teksteve para Konkilit të Trentos, bashkëkohase me “Mesharin”, si botimi i parë i Missale Romanum i vitit 1474 ose, aty ku ky meshar nuk ofron tekste për krahasim, versioni i Biblës së ashtuquajtur Vulgata të kohës para zëvendësimit të saj nga Vulgata Clementina në vitin 1592. Nevoja e ndjekjes së teksteve bashkëkohore me Buzukun, ndryshe nga praktika e deriatëhershme e marrjes parasysh të mesharëve të shekujve të mëvonshëm ose të sotëm, është argumentuar nga autori në punime të mëparshme të tij⁷, duke ndjekur hullinë e Martin Camajt i cili vuri re se Buzuku do të ketë pasur si modele tekstet dalmato-kroate të shekujve XIV-XV të shkruar me alfabetin latin⁸. Krahasimi me versionet biblike paratridentine i ka sjellë sukses autorit në analiza të caktuara gjuhësore të tekstit të Buzukut, duke shënuar kontribute të reja në zgjidhjen e disa çështjeve të rëndësishme të historisë së gjuhës shqipe e të historisë së dialekteve të saj, siç është konfirmimi i mungesës së të ardhmes me *do* në gegërishten e vjetër, si dhe për çështje të veçanta të grafisë së tekstit.⁹

Një nga risitë që sjell autori në këtë monografi është në fushën e prejardhjes së kompozimit emëror.

Nga analiza e kompozimit emëror ai ka vënë re se kompozimi i emrave në shqip nuk vjen i trashëguar nga periudha indoeuropiane. Kompozitat në dokumentet e shqipes së vjetër tregojnë se këto janë ndërtime të pavarura, sepse asnjëra prej tyre nuk mund të krahasohet me formimet kompozicionale në gjuhët e tjera i.-e. Prandaj autori nxjerr përfundimin se modeli fjalëformues i

⁷ Shih J. Matzinger, *Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2*, në: Bardhyl Demiraj (Hg.), *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992)* gewidmet, Albanische Forschungen 29, Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 2010, f. 456-460, me citimin e burimeve dhe të literaturës përkatëse. Më parë edhe në J. Matzinger, “Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischer Dokumentation”, në Monica Genesin § Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone (Hgg.), *The living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History*, Hamburg, Verlag Dr. Kovač, f. 53v.

⁸ M. Camaj, *Il “Messale” di Gjon Buzuku*, Roma, 1960, f. 56 v.

⁹ J. Matzinger, *Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2*, art. i cit., f. 456-460. Khs. dhe A. Omari, *Ndikimet sllave te Buzuku: kontributi i Camajt*, “Studime filologjike”, nr. 3-4, 2010.

kompozimit emëror në parahistorinë e shqipes ka humbur në një periudhë kohore të caktuar. Një paralelizëm silllet këtu me sistemin onomastik të shqipes, i cili, me kristianizimin e shqiptarëve të hershëm, u shndërrua krejt dhe kështu humbi edhe modeli i formimit të emrave të përveçëm vetjakë, që sipas sistemit i.-e. formoheshin nga dy pjesë përbërëse. Me këtë model humbi edhe një nga burimet e mundshme për formimin e kompozitave emërore. Një faktor tjetër, i brendshëm, për zhdukjen e kompozimit emëror indoeuropian në shqipen duhet të kenë qenë shndërrimet e mëdha fonologjike të cilat ua kanë humbur transparencën ndërtimeve kompozicionale deri sa ato kanë humbur krejt. Më pas, në një moment të caktuar të historisë së protoshqipes së hershme është shfaqur përsëri një model kompozimi emëror, ku me shumë gjasë mund të ketë luajtur rol modeli dhe ndikimi i gjuhëve të tjera me të cilat shqipja ishte në kontakt, në radhë të parë greqishtja dhe gjuhët sllave, në të cilat modeli i kompozimit emëror është shumë i gjallë. Në këtë model të ri fjalëformimi nga ana morfologjike nuk bëhet fjalë për “kompozim klasik” por thjesht për përngjitje (jukstapozicion). Kjo prejardhje dytësore e kompozimit emëror të shqipes shpjegon edhe rendin e pazakonshëm të gjymtyrëve të kompozitës në krahasim me gjuhët e tjera i.-e.

Mbas fazës paralettrare të shqipes, kur kompozitat emërore u krijuan sipas gjedhes së gjuhëve të huaja në kontakt, por me ndërtim karakteristik të brendshëm të gjuhës, erdhi një fazë më e vonë kur gjedhet e huaja imitoheshin saktësisht, pra edhe rendi i dy elementeve të kompozitës merrej i pandryshuar. Këto formime gjenden sporadikisht që në dokumentet e para shqipe, mes të cilave ka edhe formime që janë formuar që në periudhën paralettrare të shqipes.

Modeli i kompozimit emëror mori një hov të fuqishëm në kohën e shqipes së re që nga shek. 19 në periudhën e Rilindjes kombëtare dhe me lulëzimin e një literature të pasur, ku u krijuan kompozita të reja nga autorët e veçantë. Këto ndërtime të kohës së re kopjonin tashmë në mënyrë skematike modelet e kompozitave të gjuhëve të huaja që shërbenin si gjedhe imitimi, gjë që ndikon në pozicionin e dy gjymtyrëve të kompozitës, të cilat tanimë shfaqin elementin determinues në gjymtyrën e përparme dhe kokën në gjymtyrën e prapme, kështu që këto kompozita të reja përputhen përsëri krejt rastësisht me ndërtime kompozicionale indoeuropiane dhe strukturat e tyre formale. Kompozimi emëror vijon edhe sot të jetë aktiv në shqipe në krijimin e termave tekniko-shkencorë.

Kompozitat e shqipes së vjetër pasqyrohen në një tabelë, nga e cila rezultojnë 110 ndërtime të tilla emërore të dëshmuara në dokumente.

Meritojnë të vihen në dukje edhe kontributet në analizën diakronike të formanteve fjalëformuese. Në këtë rubrikë pasqyrohen arritjet dhe përvojat e mëparshme të autorit në fushën e rindërtimit historik të protoshqipes dhe të

krahasimit të rrafshit indoevropian. Kjo bie në sy sidomos në rindërtimin e formanteve me burim vendi ku rindërtohen edhe format e fazave të ndryshme të shqipes së hershme deri te paraforma e rrafshit indoevropian. Kështu veprohet p.sh. për rindërtimin e prapashtesës *-ës* ku autori konvergon me tezën e Pedersenit për një afëri të rrafshit indoevropian me prapashtesën armene *-iç* si dëshmi për përbashkësitë e këtyre dy gjuhëve në kontekstin e afërisë gjuhësore të rrafshit indoevropian ballkanik (Balkanindogermanisch).

Analizat e holla diakronike e kanë çuar autorin të rishikojë zgjidhjet etimologjike ose rrugën e formimit të disa formanteve fjalëformuese të shqipes të dhëna në mënyrë jo të kënaqshme nga autorët e mëparshëm. Kështu, për prapashtesën *-tar* ai propozon një tjetër rrugë formimi nga ajo e G. Meyerit miratuar dhe nga Xhuvani-Çabej. Meyerit mendon se kjo prapashtesë është formuar analogjikisht nga fjalë që e kanë elementin *-t* në rrënjën e tyre (pra në fjalë si *kopësht//ār* të jetë ndier si prapashtesë pjesa *-tār*, e cila është shtrirë me rrugë analogjike dhe është bërë prodhimtare si e tillë), ndërsa autori i punimit në fjalë mendon se kjo prapashtesë *-tar* është shkëputur në derivate me prapashtesën *-ār* të fjalëve bazë me *-ī*: *shtekētī* → *shtekēt//ār*, *tregētī* → *tregēt//ār* etj. Këto formime më pas u lidhën nga folësit jo me formimet kolektive me *-ī* por me bazat e tyre të thjeshta: *shtek*, *treg* etj., pra *shtek*: *shtekēt//tār*, *treg*: *tregēt//tār*. Në këtë proces mund të ketë ndikuar modeli ekzistues i prapashtesës me strukturë të ngjashme geg. vj. *-tuor/-tuer*, tosk. vj. *-tuar* i huazuar nga lat. *-tor* (f. 194 v.)

Për burimin e prapashtesës *-uor/-uer*, *-uar* mendon një zgjidhje më të pranueshme nga ajo e dhënë deri tani me rezerva, vërtet nga latinishtja *-ārius*, por me zëvendësim të *ā*-së së gjatë latine me *ā* të gjatë në shqipe siç ka ndodhur në huazimet e hershme (khs. *armissārius* > *harmëshuer*, *calendārius* > *kallënduer*, *februārius* > *fruer* etj.), e cila në mënyrë të rregullt u bë *o*, e cila u zgjat në *-ō* pranë sonantes *r*, e më tej me diftongim të **-ō* në geg. vj. *-uor*, *-uer*, tosk. vj. *-uar*. (f. 376 v.)

Për prapashtesën geg. vj. *-tuor/-tuer*, tosk. vj. *-tuar* (sot *-tor*) kundërshton mendimin e dhënë për një trashëgimi indoevropiane nga prapashtesa **-tor/-ter-* e emrave të vepruesit, për faktin se modeli i.e. me **-tor/-ter-* formon derivate prejfoljore, ndërsa modeli i shqipes me *-tuor* etj. formon vetëm derivate emërore, dhe miraton tezën e Meyerit për burimin latin *-tor* (gjin. *-tōris*) që gjendet dhe në rumanishte e arumanishte.

Për disa formante që Xhuvani-Çabej u kanë kundërshtuar burimin e huaj, ai i kthehet mendimit të huazimit. Kështu p.sh. për prapashtesën *-ësinë*, *-ësirë* i kthehet mendimit të G. Meyerit që mendon për një burim prej greqishtes; për prapashtesën *-ī*, ndryshe nga Pedersenit, Jokli e Xhuvani-Çabej që e shohin si burimore në shqipen, mendon për një huazim nga latinishtja *-īa*.

Në ndonjë rast korrigjohen disa trajta formantesh të dhëna nga studiuesit e mëparshëm, që nuk marrin parasysh zhvillimet fonetike historike brenda fjalës. P.sh. formanti *-ës* (jo *-(ë)s* - f. 158), etj.

Shqyrtimi diakronik nuk mjaftohet vetëm me përpjekjet për ndriçimin e prejardhjes së mjeteve fjalëformuese por shkon më tej duke u përpjekur të zbulojë e të rindërtojë prototipin apo pikënisjen e modelit fjalëformues. Në përgjithësi modeli zanafillor është një nocion thelbësor i gjuhës kishtare me denduri të madhe përdorimi. P.sh. në prapashtesën *-es* ka qenë lat. *servitium* që ka dhënë shqip *shërbes* e cila u lidh me foljen gjithashtu latine *shërben* dhe u lexua në ndërgjegjen gjuhësore popullore si emër i krijuar nga folja *shërb//* me prapashtesën *-es*, nga e cila u abstragua një model për formim emrash me prapashtesën *-es*. Këtë mendim e përforcon fakti që leksemat *shërbenj* dhe *shërbes* janë koncepte shumë të përdorura në gjuhën kishtare si rrezatuese e kulturës. Prototipi i prapashtesës me burim latin *-atë* propozohet të jetë derivati *oratë* (Buzuku), *uratë* (autorët e tjerë të vjetër), me burim nga folja *oroj/uroj*, leksema që janë edhe mjaft të përdorura në gjuhën kishtare. Me këtë rast polemizohet me pohimin e Xhuvani-Çabejt (SGj III 212) për një prejardhje (edhe) prejëmërore të këtij modeli fjalëformues, ku pikënisja shihet prej tyre te emra me burim latin si *kanatë*, *mblatë*. Modeli i prapashtesës *-esë*, nga një formë më e vjetër protoshqipe, mendohet të ketë qenë leksema *ëndijesë*, etj.

Tek emrat prejfoljorë të vepruesit (nomina agentis) me *-ës*, të cilët në mënyrë të bartur metonimike janë përdorur më vonë edhe si emra mjeti në gjuhë të ndryshme, për shqipen e vjetër autori ka vënë re se ky përdorim haset së pari te Da Lecce dhe te Fjalori anonim i 1710-s, në emra si *çelse* “chiave”, *fillues* “bacchetta”, *lidhëse* “benda”, *mjelëse* “secchia da mongere”, *shtypës* “pestaio, pistello” etj.

Punimi ka edhe meritën se shtron detyra për t’u zgjidhur në të ardhmen nga fusha e fjalëformimit dhe e leksikologjisë së teksteve të vjetra shqipe. Me të drejtë theksohet si një detyrë e ngutshme hulumtimi historiko-gjuhësor i fjalorit mjaft të pasur të Da Lecces dhe me atë rast të ndahen leksemat e krijuara artificialisht nga autori nga ato të realitetit gjuhësor të kohës së tij. Një ide me vlerë është ajo lidhur me studimin e çështjeve të stilistikës dhe të formimit të tekstit të dokumenteve të shqipes së vjetër, që nuk është trajtuar sa duhet.

Një çështje për t’u studiuar mbetet vjelja dhe shqyrtimi sistematik i dubleteve në fjalëformimin emëror në tekstet e vjetra, (*shërbes* ~ *shërbim*, *kujdes* ~ *kujtim*, *angjënim* ~ *angjënësë*, *trajtim* ~ *trajtj* etj.), për të vlerësuar nëse këto dublete kanë lindur si pasojë e diferencimit semantik e stilistik dhe në ç’mënyrë janë krijuar. Po ashtu edhe mbledhja dhe vlerësimi i dubleteve të tipit *arkëtuer* ~ *arkëtār*, *ndimëtār* ~ *ndimëtuar*, *shtampatuor* ~ *shtampatār*, *kies* ~ *kietār* etj. në autorë të ndryshëm ose edhe tek i njëjti autor mbetet një çështje me interes për studimet e ardhshme.

Çështja e prapashtesës *-uor/-uer, -uar*, në shqipen e sotme *-ar*, gjithashtu mbetet për t'u hulumtuar më tej për prejardhjen e saj, duke marrë në konsideratë shtresa e burime të ndryshme huazimi: së pari nga latinishtja *-ārius*, pastaj me ndërmjetësim të sllavishtes *-ar*, me ndikim të turqishtes *-er*, nga frëngji *-ier*, apo edhe nga kroatodalmatishtja *-ijer*. (f. 155, f. 377).

Gjithashtu çështja e parahistorisë diakronike të prapashtesës *pā-*, me gjithë përsiatjet etimologjike rindërtuese të autorit, ka nevojë të ndriçohet me hulumtime të mëtejshme (f. 262 v.).

Një tjetër çështje e hedhur në diskutim është ajo se si ka kaluar parafjala *pā* si gjymtyrë e parë e kompozitive privative për shprehjen e marrëdhënieve privative. Autori është i mendimit se modeli për shfaqjen e ndërtimeve prapashtesore negative me *pā* duhet të jetë marrë nga modeli i kompozitive negative me prapashtesën *bez-* “pa” të sllavishtes (p.sh. sll. vj. kisht. *bezbožstvo* “sakrilegj, veprim kundër Zotit, të qenët pa Zot” - formim prejëmëror, *bezvodьnъ* “i paujë” - prejmbiemëror) (f. 264).

Një kontribut të rëndësishëm jep punimi për turqizmat e shqipes së vjetër, duke u përqendruar në turqizmat e Buzukut, por duke hedhur vështrime të zgjeruara edhe në autorët pas tij, veçanërisht në paragrafin e modeleve të fjalëformimit me burim turk. Në turqizmat e “Mesharit” përfshihen një numër më i madh njësisht leksikore (rreth 8 njësi) në krahasim me ato që kanë dhënë studiuesit e mëparshëm, që llogariten rreth 5 njësi. Nga këto 3 leksema të shtuara, ndajfolja *tekë* “vetëm” diskutohet nga vetë autori nëse është një turqizëm i drejtpërdrejtë apo më shumë një ndikim sllav në gjuhën e Gjon Buzukut, siç mendon edhe Svane¹⁰. Mendoj se edhe dy leksemat e tjera *mill* dhe *pajë* kanë nevojë për diskutim. Turqishtja ka një *mil* me kuptimin “vegël me majë, fëndyell, bosht” që e japin G. Meyeri 278, Çabej SE V 345 e Dizdari 658 si burim të shqipes *mil* “neshter, thikë e hollë kirurgjikale e mjekëve popullorë” (it. *specillo*), sot e vjetruar dhe e dalë jashtë përdorimit. Ndërsa për fjalën *mill* (ose *myll*¹¹) “këllëf thike a shpatë” të mbarë gjuhës Çabej mendon për një vjetërsi të madhe për shkak të ruajtjes së gjinisë asnjënjëse te Buzuku, edhe pse nuk jep një etimologji të fjalës (SE V 345). Gjithashtu lidhur me fjalën *pajë* meriton një diskutim më të gjerë çështja nëse *pajë* I “plaçkat dhe pasuria që merrte me vete nusja e i çonte në shtëpinë e dhëndrit kur martohej” dhe *pajë* II “përkrahje e dikujt kur nuk ka të drejtë, anësi, anë, hatër” (FGJSSH) janë në origjinë dy fjalë të ndryshme apo një e vetme. Çabej i merr si dy fjalë më vete, të parën, fjalë e mbarë gjuhës, e rrjedhon, me Meyerin, prej lat.

¹⁰ G. Svane, *Slavische Lehnwörter im Albanischen*, Aarhus University Press, 1992, f. 274.

¹¹ Vullnetin e Perëndisë,/dot me çelës nuk e mbyll/kur Ajo të jep një shpatë,/s'mund ta mbash vetëm në myll!, Arben Duka, <http://www.gazetadita.al/pena-dhe-shpata/>. Khs. dhe Fan Noli, *Fute shpatën në myll*, Hamleti.

pallium, kurse të dytën, fjalë e gegërishtes, prej turq. *pay* “pjesë, dasik, porcion” (SE VI, f. 116-117). Nga ana kuptimore, *pajë* I dhe *pajë* II bashkohen në disa përbërës semantikë të tyre me kuptimin “pjesë që i takon dikujt” që ka fjala turke *pay*. Por nga ana tjetër, ekzistenca e *-l*-së ndërzanore në variantin *palë* të tosk. jugore të Gjirokastrës dhe të çamërishtes flet për një **l̥* > *lj* të dikurshme, e cila në këto të folme ka kaluar në *l*, ndërsa në mbarë gjuhën është spirantizuar në *j*. Veç kësaj, në tosk. jugore turqizmat marrin theks fundor, jo parafundor. Këto të dhëna flasin për një vjetërsi më të madhe të fjalës *pajë* I dhe e ndajnë fonetikisht nga *pajë* II, duke i dhënë të drejtë Çabejt, i cili i ndan edhe kuptimisht këto fjalë nuk e afron *pajë* I me turqishten.

Si përfundim, me këtë punim studimi i gramatikës së shqipes së vjetër të fazave të dokumentuara të saj shënon një hap të rëndësishëm përpara në plotësimin e zbrazëtive të trashëguara, të cilat tashmë po mbushen hap pas hapi, edhe me meritat e albanologëve gjermanishtfolës, që vijojnë traditën e nderuar të albanologjisë tashmë treshekullore gjermane.